




QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

DIALOGU KOSOVË-SERBI

SHQYRTIMI I PERCEPTIMEVE TË
TË ANKETUARVE

SHKURT 2020





QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

DIALOGU KOSOVË-SERBI

SHQYRTIMI I PERCEPTIMEVE TË TË ANKETUARVE

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Interpretimi i të dhënave: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni në: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe tregojnë mënyrën si i perceptojnë ata institucionet. Ky nuk është vlerësim përfundimtar i punës së institucioneve që janë temë e këtij studimi. Raporti do t'u shërbejë atyre si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinione të shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

PËRMBAJTJA

TABELA E FIGURAVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
KAPITULLI 1 - RREZIQET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË KOSOVË	10
KAPITULLI 2 - DIALOGU KOSOVË-SERBI 2.0	13
KAPITULLI 3 - MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME PARTNERËT RAJONALË DHE NDËRKOMBËTARË	18
METODOLOGJIA	
ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	22

TABELA E FIGURAVE

Figura 1 - Rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë (pyetje e hapur)	10
Figura 2 - Rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë (pyetje e mbyllur)	11
Figura 3 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë – sipas përbërjes gjinore të të anketuarve	12
Figura 4 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë - sipas viseve të të anketuarve	12
Figura 5 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve	12
Figura 6 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rrezik i brendshëm ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë - sipas rajoneve të të anketuarve	12
Figura 7 - Perceptimet e të anketuarve nëse dialogu Kosovë-Serbi duhet të vazhdojë (pyetje e hapur)	13
Figura 8 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia	14
Figura 9 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia – sipas përbërjes gjinore të të anketuarve	14
Figura 10 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia - sipas viseve të të anketuarve	14
Figura 11 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve	15

Figura 12 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia - sipas rajoneve të të anketuarve	15
Figura 13 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë	16
Figura 14 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas përbërjes gjinore të të anketuarve	16
Figura 15 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas viseve të të anketuarve	16
Figura 16 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve	17
Figura 17 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas rajoneve të të anketuarve	17
Figura 18 - Partnerët dhe aleatët më me ndikim strategjik në Kosovë sipas perceptimeve të të anketuarve	18
Figura 19 - Partnerët dhe aleatët e Kosovës me më pak ndikim sipas perceptimeve të të anketuarve	19
Figura 20 - Shtetet me ndikimin më të dëmshëm ndaj politikës së jashtme të Kosovës sipas perceptimeve të të anketuarve	19
Figura 21 - Perceptimet ndaj Gjermanisë, ShBA-ve dhe Shqipërisë - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve	20
Figura 22 - Perceptimet ndaj Serbisë, Ruisë dhe Kinës - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve	21

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky botim special i Barometrit Kosovar të Sigurisë zbërthen perceptimet publike në Kosovës lidhur me kërcënimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës, çështjet që lidhen me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe mendimet e të anketuarve rreth shteteve të Ballkanit Perëndimor, shteteve evropiane dhe fuqive globale që kanë ndikim mbi politikën e jashtme të Kosovës. Ky raport interpreton në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të dhënat në lidhje me perceptimin e opinionit publik bazuar në një varg të pyetjeve të paracaktuara lidhur me çështjet në fjalë.

Në këtë drejtim, ky raport paraqet perceptimin e të anketuarve të Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2019 lidhur me ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale, përfshirë Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë të cilat perceptohen si kërcënime ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës nga shumica e të anketuarve. Në kontekstin e dialogut Kosovë-Serbi, raporti e adreson perceptimin e publikut lidhur me tarifatat doganore të Kosovës ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina dhe nëse tarifatat i kanë dobësuar marrëdhëniet e Kosovës me partnerët e saj ndërkombëtarë. Në lidhje me politikën e jashtme të Kosovës, raporti i pasqyron qëndrimet e të anketuarve sa i përket ndikimit të shteteve të huaja ndaj Kosovës.

Përveç interpretimit të përgjithshëm të të dhënave nga anketat për këto tema, raporti e jep një analizë të të dhënave të

tërthorta tabelare në bazë të rajoneve, viseve rurale/urbane, ekuilibrit gjinor dhe përbërjes etnike të të anketuarve.

Pasi që Barometri Kosovar i Sigurisë është realizuar në mes të tetorit 2019, ky raport nuk i pasqyron disa nga zhvillimet që kanë ndodhur nga muaji nëntor i vitit 2019 deri në janar të vitit 2020 në Kosovë.

Gjetjet kyçe të raportit janë renditur më poshtë:

- Korrupsioni në Kosovë perceptohet si rreziku më i lartë ndaj sigurisë kombëtare të shtetit të Kosovës. Shumica dërmuese e të anketuarve ose 91.41 përqind e tyre e perceptojnë korrupsionin si rrezikun më të madh të brendshëm në Kosovë.
- Papunësia (90.98 përqind) renditet në vendin e dytë dhe krimi i organizuar (89.31 përqind) renditet në vendin e tretë si rreziqe ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës.
- Vlen të përmendet se çështjet më tematike në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, më saktësisht ndarja e Kosovës ose shkëmbimi territorial ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (78.48 përqind) dhe autonomia territoriale për Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë (64.61 përqind) perceptohen nga të anketuarit si rreziqe të nivelit të lartë ndaj sigurisë kombëtare. Sa i përket dialogut Kosovë-Serbi, shumica e qytetarëve janë në

favor të rifillimit të dialogut. Pothuajse 50 përqind e të anketuarve deklaruan se dialogu duhet të vazhdojë.

- Ndërsa, 21 përqind e të anketuarve shprehën qëndrimet e tyre se dialogu duhet të kushtëzohet me njohje nga Serbia të pavarësisë së Kosovës dhe të krimeve të luftës të kryera në Kosovë gjatë luftës. Përkundër kësaj, pothuajse 15 përqind e të anketuarve shprehën mendimin se dialogu nuk duhet të vazhdojë.
- Sa i përket tarifave doganore të Kosovës ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, të anketuarit shprehën qëndrime të ndryshme. Perceptimi i 35.32 përqind e tyre është se tarifatat duhet të mbeten në fuqi, ndërsa 32,97 përqind e të anketuarve shprehën mendimin se tarifatat duhet të zëvendësohen me aplikimin e masave të reciprocitetit të plotë të Kosovës ndaj Serbisë.
- Gjithashtu, rezultatet tregojnë se rreth 22 përqind e të anketuarve thanë se tarifatat duhet të hiqen nga Qeveria e Kosovës.
- Gjetjet e edicionit të vitit 2019 të Barometrit Kosovar të Sigurisë tregojnë se të anketuarit shprehën percep-

time të ndryshme lidhur me atë nëse tarifatat doganore i kanë zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët e saj ndërkombëtarë. Kështu, rreth 33.47 përqind e të anketuarve nuk pajtohen që tarifatat zbehen marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë. Sidoqoftë, rreth 30.28 përqind e tyre deri diku pajtohen dhe 27.33 përqind të tjera pajtohen se tarifatat doganore të Kosovës ndaj Serbisë i dobësuan lidhjet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë.

- Për sa i përket partnerëve strategjikë dhe aleatëve të Kosovës, të dhënat e anketës tregojnë se Gjermania (79.85 përqind), Shtetet e Bashkuara (78.60 përqind), Shqipëria (69.69 përqind) dhe Mbretëria e Bashkuar (62.85 përqind) perceptohen si shtetet më miqësore ndaj Kosovës.
- Nga ana tjetër, Serbia konsiderohet si shteti me ndikimin më të dëmshëm ndaj Kosovës nga 89.86 përqind e të anketuarve, e ndjekur nga Rusia (81.35 përqind) dhe Kina (59.61 përqind).

RREZIQET NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË KOSOVË

Barometri Kosovar i Sigurisë i ka pyetur të anketuarit për çështjet më sfiduese si pasojë e rreziqeve më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Kjo ishte pyetje e hapur ku të anketuarit ishin të lirë t'i shprehin mendimet e tyre se cili është rreziku kryesor i brendshëm ndaj sigurisë kombëtare brenda vendit.

Ngjashëm me vitet e kaluara, korrupsioni ishte rreziku më i madh në Kosovë gjatë vitit 2019 duke u llogaritur si

problemi kryesor brenda shtetit nga pothuajse 20 përqind e të anketuarve, i ndjekur nga papunësia si rreziku i dytë më i madh ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë dhe ndërhyrjen e saj në punët e brendshme të Kosovës perceptohen nga të anketuarit si rreziku i tretë më i madh ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës nga pothuajse 15 përqind e të anketuarve, siç tregohet në figurën vijuese.




Figura 1 - Rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë (pyetje e hapur)

Rreziqet tjera të përmendura nga të anketuarit janë krimi (7 përqind), politikanët dhe partitë politike (më pak se 7 përqind), migrimi (gati 4 përqind) dhe rreziqe tjera të theksuara në edicionin e anketës së vitit 2019 të Barometrit Kosovar të Sigurisë.

Përveç pyetjes së hapur për këtë çështje, BKS në vitin 2019 e ka matur edhe perceptimin e të anketuarve se cilat janë rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës përmes pyetjes së mbyllur me disa opsione. Ndër opsionet e renditura në pyetje, korrupsioni në Kosovë është rrezikur kyç dhe i pari në listën e rreziqeve të


brendshme që e prekin sigurinë kombëtare të shtetit. Shumica dërmuese e të anketuarve ose 91.41 përqind e tyre e perceptojnë korrupsionin si rrezikun më të madh të brendshëm në Kosovë. Ai pasohet nga papunësia (90.98 përqind) në vendin e dytë dhe krimi i organizuar (89.31 përqind) renditet në vendin e tretë.

Figurat e mëposhtme (nga figura 3 deri në figurën 7) ilustrjnë mendimet e të anketuarve për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të mëdha ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës.



Figura 2 - Rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë (pyetje e mbyllur)

Ndarja e Kosovës



Autonomia territoriale/Asociacioni i komunave me shumicë serbe





Figura 3 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë – sipas përbërjes gjinore të të anketuarve

Ndarja e Kosovës



Autonomia territoriale/Asociacioni i komunave me shumicë serbe




Figura 4 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë - sipas viseve të të anketuarve








Figura 5 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rreziqe të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

Ndarja e Kosovës



Autonomia territoriale/Asociacioni i komunave me shumicë serbe






Figura 6 - Perceptimet për ndarjen e Kosovës dhe autonominë territoriale/Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë si rrezik i brendshëm ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë - sipas rajoneve të të anketuarve

DIALOGU KOSOVË-SERBI 2.0

Gjatë viteve të fundit dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë i varur dhe i ndikuar në masë të madhe nga tarifa doganore 100 përqind e vendosur nga Qeveria e Kosovës ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina në fund të nëntorit të vitit 2018.¹ Sa i përket ndërprerjes së përkohshme të dialogut Kosovë-Serbi, shumica e qytetarëve megjithatë janë shprehur në favor të rifillimit të

dialogut. Rrjedhimisht, pothuajse 50 përqind e të anketuarve deklaruan se dialogu duhet të vazhdojë dhe marrëveshja duhet të arrihet. Të anketuarit tjerë theksuan se dialogu duhet të kushtëzohet me njohje të pavarësisë së Kosovës dhe krimeve të luftës nga Serbia të kryera në Kosovë gjatë luftës. Në anën tjetër, pothuajse 15 përqind e të anketuarve shprehën mendimin se dialogu nuk duhet të vazhdojë.




Figura 7 - Perceptimet e të anketuarve nëse dialogu Kosovë-Serbi duhet të vazhdojë (pyetje e hapur)

¹ Vendimi i Qeverisë së Kosovës për tarifën doganore 100 përqind ndaj Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës mund të gjendet këtu: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/11/Lista-e-mallrave-te-perjashtuara.pdf>.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë i ka pyetur të anketuarit për tarifatat doganore ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Këtu mendimi i 35 përqind e tyre është se tarifatat duhet të mbeten në fuqi, ndërsa afro 33 përqind e të anketuarve shprehën mendimin

se tarifatat duhet të zëvendësohen me masat e reciprocitetit të plotë të Kosovës ndaj Serbisë. Në anën tjetër, rezultatet tregojnë se rreth 22 përqind e të anketuarve mendojnë se tarifatat ndaj Serbisë duhet të hiqen nga Kosova.




Figura 8 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia




Figura 9 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia – sipas përbërjes gjinore të të anketuarve




Figura 10 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia - sipas viseve të të anketuarve




Figura 11 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve




Figura 12 - Perceptimet se si duhet të reagojë Kosova ndaj tarifës 100 përqind për mallrat e importuara nga Serbia - sipas rajoneve të të anketuarve

Të anketuarit kanë perceptime mjaft të ndryshme nëse tarifatat doganore të Kosovës ndaj Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës i kanë zbehur ose dobësuar marrëdhëniet e shtetit të Kosovës me partnerët ndërkombëtarë. Kështu, rreth 33 përqind e të anketuarve nuk pajtohen që tarifatat kanë zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë. Sidoqoftë, rreth 30 përqind e tyre deri diku pajtohen dhe 27 përqindëshi i mbetur pajtohen se tarifatat doganore të Kosovës ndaj Serbisë i dobësuan marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë.




Figura 13 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë




Figura 14 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas përbërjes gjinore të të anketuarve




Figura 15 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas viseve të të anketuarve




Figura 16 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve




Figura 17 - Perceptimet nëse tarifa 100 përqind ndaj mallrave të importuara nga Serbia ka zbehur marrëdhëniet e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë - sipas rajoneve të të anketuarve

MARRËDHËNIET E KOSOVËS ME PARTNERËT RAJONALË DHE NDËRKOMBËTARË

Edicioni i Barometrit Kosovar të Sigurisë për vitin 2019 ka matur edhe perceptimet publike të të anketuarve lidhur me shtetet e Ballkanit Perëndimor, shtetet evropiane si dhe fuqitë globale që kanë ndikim në Kosovë. Është me rëndësi të theksohet se Gjermania (79.85 përqind), Shtetet e Bashkuara (78.60 përqind), Shqipëria (69.69 përqind)

dhe Mbretëria e Bashkuar (62.85 përqind) perceptohen si shtetet më miqësore ndaj Kosovës.

Ato pasohen nga Kroacia (42.46 përqind) dhe Franca (41.20 përqind).




Figura 18 - Partnerët dhe aleatët më me ndikim strategjik në Kosovë sipas perceptimeve të të anketuarve

Përveç kësaj, shtetet tjera të renditura si partnerë me më pak ndikim në Kosovë janë Turqia me rreth 34 përqind si

shumë miqësore, Maqedonia e Veriut me rreth 20 përqind si shumë miqësore dhe Mali i Zi me rreth 16 përqind sosh.




Figura 19 - Partnerët dhe aleatët e Kosovës me më pak ndikim sipas perceptimeve të të anketuarve

Ndërsa, shtetet që e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës duke mos e njohur si shtet konsiderohen kryesisht si të dëmshme nga të anketuarit sipas rezultateve të Barometrit Kosovar të Sigurisë. Prandaj, Serbia konsiderohet si shteti me ndikimin më të dëmshëm në Kosovë nga rreth 89 përqind

e të anketuarve, e ndjekur nga Rusia (rreth 81 përqind e shohin atë si të dëmshme) dhe Kina (gati 60 përqind e perceptojnë ndikimin e saj si të dëmshëm për Kosovën).




Figura 20 - Shtetet me ndikimin më të dëmshëm ndaj politikës së jashtme të Kosovës sipas perceptimeve të të anketuarve

Krahas kësaj, në vijim janë paraqitur të dhëna shtesë nga aspekti i përkatësisë etnike për të analizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse perceptimet e komuniteteve etnike në

Kosovë ndaj shteteve më me ndikim dhe me më së paku ndikim në politikën e jashtme të Kosovës.






Figura 21 - Perceptimet ndaj Gjermanisë, ShBA-ve dhe Shqipërisë - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve



PERCEPTIMET NDAJ SERBISË



PERCEPTIMET NDAJ RUSISË



PERCEPTIMET NDAJ KINËS




Figura 22 - Perceptimet ndaj Serbisë, Rusisë dhe Kinës - sipas përkatësisë etnike të të anketuarve

METODOLOGJIA

ÇKA ËSHTE BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i krijuar në shtator të vitit 2012. Qëllimi i tij kryesor është që të mat besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë si dhe të mat perceptimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme që i kanosen Kosovës.

BKS është aktiviteti i parë dhe më i madhi i këtij lloji i dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një forum vendor në Kosovë. Duhet theksuar se ajo që e bën unik BKS në Kosovë është neutraliteti i tij politik. Si një forum i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike në komunikimin e çfarëdo gjetjeje dhe mesazhi të hulumtimit.

BKS përdor kombinim të metodave cilësore dhe sasiore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e tij mbledhen përmes intervistave personale me të anketuarit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme që zhvillohen nga hulumtuesit e QKSS në terren anembanë Kosovës. Pyetëtori i QKSS përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës pesë-pikëshe të Likertit, që pasoheshin me disa pyetje të hapura që u mundësonin të anketuarve të japin mendimet e tyre pa u dhënë opsione të paracaktuara të përgjigjeve.

Ekipi i QKSS prej 29 hulumtuesve ka bërë pilotimin dhe intervistat. Mostra në nivel vendi nga të cilat u nxor ky hulumtim përfshinte 1,189 familje, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi moshën 18 vjeçe në Kosovë. Përkatësia etnike e personave të intervistuar ishte: 89 përqind shqiptarë të Kosovës, 7.4 përqind serbë dhe 2 përqind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptian dhe goran) që reflektonin përbërjen etnike të Kosovës. Korniza e mostrës bazohej në zona sipas kodeve hyrëse telefonike dhe si e tillë përfshinte këto tetë rajone: Ferizajn, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin.

Faza e parë e grupimit gjeografik bazohej në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë 2012. Faza e dytë përfshinte grupimin e mostrave për zona komunale me mostër të stratifikuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit u zhvillua sipas metodës së caktimit të rastësishëm të mostrës duke përdorur 'metodën e ditëlindjes' më të afërt.



Caktimi i rastësishëm i mostrës siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të zgjidhet për intervistë. Me mostrën e zgjedhur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e tërë popullsisë së rritur të Kosovës në përgjithësi.

Margjina e gabimit është 3 përqind me interval të besueshmërisë prej 95 përqind.


Një intervistë testuese u zhvillua në fund të muajit shtator për të testuar sa është i plotë pyetësi para fillimit të punës në terren. Ekipi hulumtues pastaj raportoi se intervista testuese ishte e suksesshme dhe se nuk ishin hasur probleme me instrumentin testues. Të gjitha intervistat u kryen

nga 9 tetor deri më 16 tetor 2019. Të dhënat u përpunuan dhe analizuan duke përdorur softuerin SPSS.


Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informacioneve të marra nga të anketuarit dhe ai demonstroi se si njerëzit i perceptojnë institucionet kosovare.




Të anketuarit sipas gjinisë




Të anketuarit sipas Zonës së Vendbanimit



Hulumtimi në terren



Mosha



Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327(496.51:497.11)(047)

Dialogu Kosovë-Serbi: shqyrtimi i perceptimeve të të anketuarve / Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. - 28 f. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-799-03-4

www.qkss.org

ISBN 978-9951-799-03-4



9 789951 799034